



# UDHËRRËFYESI I STUDENTËVE





## UDHËRRËFYESI I STUDENTËVE

- UNIKO me pak fjalë
  - Misioni
  - Vizioni
  - Senati akademik
  - Bordi i administrimit
  - Rektorati
  - Rektori
  - Zëvendësrektorët
  - Administratori
- Periudha e studimeve
  - Forma dhe gjuha e studimeve
  - Kohëzgjatja e studimeve
  - Pjesëmarrja në veprimtari mësimore
  - Vlerësimi
  - Diplomimi dhe diploma
  - Regjistrimi/Transferime
- Sekretaria mësimore
  - Sekretaria e departamenteve
  - Fakultetet dhe departamentet
  - Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë
  - Fakulteti i Bujqësisë
  - Fakulteti i Shkencave Natyrore dhe Shkencave Humane
  - Fakulteti i Ekonomisë
- Biblioteka dhe databazat
  - Sigurimi i cilësisë në UNIKO 17 -
  - IRO- Zyra e marrëdhënieve me jashtë, koordinatori i ERASMUS+
  - Zyra IT
  - Këshilli studentor
  - Qendra e karrierës dhe ALUMNI
- Rregullore e organizimit dhe funksionimit të KS
  - Kodi i Etikës
  - Rregullorja e zhvillimit të provimeve



**UDHËRRËFYESI  
I STUDENTËVE**

# **UNIVERSITETI "FAN S. NOLI" ME PAK FJALË**

Universiteti "Fan S. Noli" është një institucion i arsimit të lartë, i vendosur në qendër të juglindjes së Shqipërisë, në qytetin e Korçës. UNIKO është ngritur mbi bazën e Institutit të Lartë Bujqësor të Korçës, i cili funksionoi si i tillë prej vitit 1971-1992. Veprimtarinë akademike Universiteti i Korçës e filloi në janar të vitit 1992, me tre fakultete: me Fakultetin e Bujqësisë, të Mësuesisë dhe fakultetin e Ekonomisë. Në vitin 1994 i'u dha emri "Fan S. Noli" dhe, po në këtë vit, pranë tij u çel edhe programi i studimit "Infermieri". Në vitin akademik 2009-2010 u hap në qytetin e Pogradecit filiali i Universitetit të Korçës në programin e studimit "Turizëm", i cili funksionoi si i tillë deri në vitin 2014. Në vitin akademik 2011-2012 Fakulteti i Mësuesisë u nda në dy fakultete: Fakulteti i Shkencave Natyrore dhe Shkencave Humane dhe Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë.

Sot, UNIKO ka 4 fakultete dhe ofron diploma universitare në 57 programe studimi në të tre ciklet, si dhe programe profesionale 2-vjeçare. Studimet në Universitetin e Korçës përfshijnë fusha të tilla si: edukim dhe filologji, ekonomi, bujqësi, shkencë natyrore e humane, shkencë mjekësore etj.

Viti akademik 2014-2015, shënoi një vit të veçantë në jetën e këtij Universiteti. Presidenti i Republikës së Shqipërisë, e nderoi Universitetin e Korçës me titullin "Nderi i Kombit", për kontributin ndër vite të stafit akademik, i cili me pasion dhe përkushtim hodhi themelet e këtij institucioni. UNIKO ka mbi 120 marrëveshje aktive bashkëpunimi me institucione arsimore dhe joarsimore, brenda dhe jashtë vendit. Në kuadër të partneriteteve janë kryer shkëmbime të stafëve akademike, kërkuesve dhe studentëve, janë zhvilluar veprimtari të përbashkëta kërkimore-shkencore, konferenca, takime, seminare etj., në interes të ngritjes së vazhdueshme të cilësisë dhe zhvillimit të arsimit të lartë.

UNIKO prej vitit 2018 është anëtare me të drejta të plota në Shoqatën e Universiteteve të Ballkanit (BUA), si dhe në Shoqatën Universitare të Frankofonisë (AUF). Universiteti "Fan S. Noli" i Korçës në procesin e Akreditimit Institucional të zhvilluar gjatë vitit 2017, u akreditua me kohëzgjatjen prej 5-vitesh, duke marrë vlerësime maksimale nga Agjencia Britanike e Akreditimit Institucional. Aktualisht, UNIKO është në proces për akreditimin e programeve të studimit. Mbarëvajtja e këtij procesi periodik dhe realizimi i tij në përputhje me legjislacionin në fuqi është në qendër të veprimtarisë së Institucionit.



**UDHËRRËFYESI  
I STUDENTËVE**

## Misioni

Universiteti “Fan S. Noli” i Korçës në të gjithë veprimtarinë e tij ka për mision të krijojë, të transmetojë, të zhvillojë dhe të mbrojë dijet me anë të mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe shërbimeve. UNIKO si një institucion mësimor dhe kërkimor ka për qëllim të nxisë vlerat themelore njerëzore përmes zhvillimit të njohurive në nivele sa më të larta, në funksion të përmirësimit të cilësisë së jetës shoqërore në rajon dhe më gjerë. Në këtë kontekst, Universiteti “Fan S. Noli” synon të rrisë individë të përgatitur, produktivë dhe kompetentë me një frymë të orientuar në kërkime, të cilët posedojnë etikë profesionale dhe ndjeshmëri sociale dhe janë gjithashtu të hapur drejt sfidave kombëtare dhe ndërkombëtare.

UNIKO synon t'iu sigurojë punonjësve akademikë pavarësinë e kërkimit dhe lirinë e mësimdhënies, si dhe të garantojë shprehjen e lirë të ideve, duke u krijuar studentëve mundësi të barabarta për punë dhe studim.

## Vizioni

Vizioni i UNIKO mbështetet në zhvillimin e kapaciteteve njerëzore për veprimtarinë kërkimore-shkencore, përmirësimi i infrastrukturës për punë kërkimore-shkencore dhe për ofrimin e shërbimeve, ndërkombëtarizimi dhe rajonalizimi i veprimtarisë kërkimore-shkencore, duke nxitur cilësinë në kërkime, bashkëpunimin me sektorin publik dhe privat në realizimin e projekteve kërkimore, që janë në funksion të zhvillimit ekonomik dhe shoqëror.



**UDHËRRËFYESI  
I STUDENTËVE**

## **Senati akademik**

Senati Akademik është organi më i lartë kolegjal vendimmarrës i UNIKO. Senati Akademik përcakton politikat e zhvillimit të institucionit, programon, bashkërendon, drejton dhe kontrollon veprimtaritë e mësimdhënies e të kërkimit shkencor, si dhe vlerëson efikasitetin e tyre. Senati Akademik vendos për çështje të rëndësishme të Universitetit në fushën e mësimin, kërkimit shkencor, administrativ dhe financiar. Pasi merr miratimin e Bordit të Administrimit, miraton planin vjetor të veprimtarive akademike dhe kërkimore-shkencore të Universitetit, si dhe miraton raportin e detajuar vjetor të veprimtarisë së UNIKO të hartuar nga Rektorati. Senati Akademik i UNIKO ka edhe dy përfaqësues nga studentët.

## **Bordi i administrimit**

Bordi i Administrimit i UNIKO është organi më i lartë drejtues administrativ. Ai përbëhet nga shtatë anëtarë, ku njëri prej tyre zgjidhet nga votimi i drejtpërdrejtë i studentëve. Bordi i Administrimit garanton qëndrueshmërinë financiare të UNIKO në përmbushjen e misionit të tij, miraton planin strategjik të zhvillimit të institucionit, buxhetin vjetor dhe atë afatmesëm dhe mbikëqyr zbatimin e tyre, jep mendim për projektrregulloren e Universitetit dhe miraton rregulloren financiare të tij; përcakton rregullat për shpërndarjen e të ardhurave që siguron Universiteti nga ushtrimi i veprimtarive të tij, si dhe mbikëqyr përdorimin e burimeve të financimit.



**UDHËRRËFYESI  
I STUDENTËVE**

# Rektorati

Rektorati është organi kolegjal që drejtohet nga rektori dhe në përbërje të të cilit janë rektori, zëvendësrektori/ët, administratori i institucionit, drejtuesit e njësive kryesore dhe autoritete të tjera. Rektorati harton planin strategjik të zhvillimit të UNIKO, harton programin vjetor të veprimtarisë mësimore-kërkimore, raportin vjetor të veprimtarisë mësimore-kërkimore, harton planin për bashkëpunimet dhe marrëveshjet që janë kompetencë e tij, monitoron veprimtarinë e Universitetit dhe publikon rezultatet e vlerësimit të tij. Rektorati vë në dispozicion infrastrukturën dhe shërbimin administrativ për mbarëvajtjen e veprimtarisë së Universitetit dhe organeve të tij, si dhe realizon kontrole periodike në njësitë e Universitetit për përmbushjen e objektivave të parapara.

## Rektori

Rektori është autoriteti më i lartë akademik i Universitetit të Korçës, si dhe përfaqësuesi ligjor i tij. Rektori zgjidhet nga anëtarët e asambleve të personelit akademik të njësive kryesore dhe studentët e UNIKO. Rektori drejton Senatin Akademik, raporton para tij, si dhe i paraqet planin strategjik të zhvillimit të Universitetit. Rektori gëzon të drejtën të informohet nga autoritetet drejtuese të të gjitha njësive për vendimet dhe masat e marra prej tyre. Lëshon /konfirmon, përkundërt firmës, diplomat e përfundimit të studimeve universitare dhe pasuniversitare, pa patur të drejtën e delegimit të firmës personave të tjerë; nënshkruan kontratat e punës të personelit akademik dhe ndihmësakademik. Gjithashtu, Rektori përfaqëson UNIKO në Konferencën e Rektorëve të Universiteteve Shqiptare, si anëtar i saj.



**UDHËRRËFYESI  
I STUDENTËVE**

## **Zëvendësrektorët**

Pjesë e organizimit dhe drejtimit akademik të UNIKO janë edhe dy zëvendësrektorë, të cilët emërohen nga Rektori, pas miratimit të kandidaturave të propozuara prej tij nga Senati Akademik.

- **Zëvendësrektori**

**për mësimin** organizon dhe kontrollon punën mësimore në nivel universiteti, ndjek hartimin dhe zbatimin e planeve dhe të programeve mësimore për dy ciklet e studimit ("Bachelor", "Master i Shkencave", "Master Profesional"), harton strukturën e vitit akademik për procesin mësimor në shkallë Universiteti dhe, në bashkëpunim me strukturat ndihmëse, përgatit raportin vjetor të veprimtarisë mësimore të Universitetit.

- **Zëvendësrektori**

**për kërkimin dhe shkencën** ndjek dhe kontrollon ecurinë e zhvillimit të punës kërkimore-shkencore dhe projekteve në nivel Universiteti. Ai(ajo) ndjek hartimin dhe zbatimin e planeve dhe të programeve mësimore për ciklin e tretë të studimeve (studime doktorale), kontrollon punën për specializimet pasuniversitare afatgjata brenda

dhe jashtë shtetit të punonjësve mësimorë-shkencorë të UNIKO, në bashkëpunim me strukturat ndihmëse, përgatit raportin vjetor të veprimtarisë kërkimore të Universitetit, si edhe organizon kryerjen e studimeve për zhvillimin perspektiv të Universitetit "Fan S. Noli" në fushën e kërkimit.



**UDHËRRËFYESI  
I STUDENTËVE**

# **Administratori**

Administratori është autoriteti më i lartë administrativ dhe përgjegjës për mirëfunksionimin financiar të UNIKO. Administratori përzgjidhet me konkurs të hapur nga Bordi i Administrimit me 2/3 e votave të anëtarëve. Administratori i UNIKO harton planin buxhetor afatmesëm të institucionit, harton projektbuxhetin vjetor, mbi bazën e propozimeve të njësive kryesore dhe të njësive bazë, si dhe në planin buxhetor afatmesëm të tij, propozon kriteret për administrimin e burimeve financiare dhe materiale, të cilat ia paraqet për miratim Bordit të Administrimit. Ndjek dhe kontrollon zbatimin e buxhetit vjetor të Universitetit në strukturat e varësisë së tij, përgjigjet për veprimtarinë ekonomike dhe financiare, organizon kryerjen e studimeve për zhvillimin perspektiv të UNIKO, si dhe është përgjegjës direkt për performancën administrative dhe financiare të Universitetit.





**UDHËRRËFYESI  
I STUDENTËVE**

## **Sekretaria mësimore**

Sekretaria mësimore është struktura bazë administrative ndihmëse në shërbim të procesit mësimor në Universitet. Sekretaria mësimore është kontakti i parë i çdo studenti në Universitetin e Korçës dhe përgjigjet për organizimin dhe mirëfunksionimin e procesit të regjistrimeve, të transferimeve, të provimeve, për procesin e lëshimit të diplomave, si dhe mbajtjen e regjistrit të të dhënave të studentëve. Sekretaria mësimore përbëhet nga kryesekretari dhe sekretarët. Vendodhja e sekretarive është në katet e para të çdo fakulteti.

## **Sekretaria e departamenteve**

Gjatë zhvillimit të studimeve në UNIKO studenti i drejtohet sekretarive të departamenteve në çdo fakultet për të marrë informacion në lidhje me programin përkatës, lëndët specifike, sezonet dhe procedurat e provimeve e riprovimeve, problemet gjatë regjistrimit në to etj.



**UDHËRRËFYESI  
I STUDENTËVE**

## Fakultetet dhe departamentet

Universiteti "Fan S. Noli" ka 4 fakultete dhe  
15 departamente

### 1. Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë

- Departamenti i Edukimit
- Departamenti i Gjuhëve të huaja
- Departamenti i Gjuhës dhe i Letërsisë
- Departamenti i Histori-  
Gjeografisë

### 2. Fakulteti i Bujqësisë

- Departamenti i Agronomisë
- Departamenti i Agroushqimit
- Departamenti i Agrobiznesit

### 3. Fakulteti i Shkencave Natyrore dhe Shkencave Humane

- Departamenti i Biologji-Kimisë
- Departamenti i Infermierisë
- Departamenti i Matematikës
- Departamenti i Informatikës
- Departamenti i Shkencave Sociale

### 4. Fakulteti Ekonomik

- Departamenti i Financë -  
Kontabilitet
- Departamenti i Marketing-Turizmit
- Departamenti i Menaxhimit





**UDHËRRËFYESI  
I STUDENTËVE**

# Periudha e studimeve

Studimet në UNIKO zhvillohen në vite akademike, ku data zyrtare e fillimit të vitit të ri akademik shpallet nga ministri përgjegjës për arsimin. Viti akademik organizohet në dy semestra që realizojnë 20 - 25 orë mësimore 50- minutëshe në javë, të cilat janë leksione, seminare, praktika, orë në laboratorë.

## Forma dhe gjuha e studimeve

Studimet në UNIKO janë me kohë të plotë:

- Studimet e ciklit të parë “Bachelor” ;
- Studimet e ciklit të dytë “Master profesional” dhe “Master i Shkencave”;
- Studimet e ciklit të tretë “Doktor i Shkencave” ;
- Programe profesionale 2- vjeçare .

Programet e studimit në UNIKO ofrohen në gjuhën shqipe, me përjashtim të programeve të përbashkëta të studimit të ofruara nga Universiteti i Korçës me institucione të huaja të arsimit të lartë dhe programet e studimit që kanë për objekt mësimin e gjuhëve të huaja.



**UDHËRRËFYESI  
I STUDENTËVE**

## **Kohëzgjatja e studimeve**

Kohëzgjatja maksimale për një program studimi nuk mund të jetë më shumë se dyfishi i kohëzgjatjes normale së studimeve që parashikon programi, pa marrë në konsideratë periudhën e kohës, kur studenti i ka pezulluar studimet. Studenti, që nuk arrin të përfundojë studimet brenda kohëzgjatjes maksimale të programit, ka të drejtë të aplikojë për të rifilluar studimet, në të njëjtin program studimi ose në një program tjetër.

- Për studimet "Bachelor" kohëzgjatja është 3 vite akademike.
- Për studimet "Master" kohëzgjatja është 1.5 ose 2 vite akademike.
- Për studimet në programet profesionale kohëzgjatja është 2 vite akademike.

## **Pjesëmarrja në veprimtari mësimore**

Pjesëmarrja në veprimtari mësimore nënkupton angazhimin e studentit në mësim në auditor (leksione, seminare, ushtrime, laboratore, forma të kontrollit të vazhdueshëm dhe seanca të praktikave profesionale), studim individual (punim relacionesh, detyrash apo projektesh, përgatitje për provime), përgatitje e tezës së diplomës, veprimtari të tjera (praktika profesionale, praktika në terren apo stazh pranë subjekteve publike ose private). Studentëve, në përfundim të programit të studimit, u përlllogaritet nota mesatare e ponderuar, që merr në konsideratë edhe kreditet respektive për çdo disiplinë apo veprimtari tjetër formuese.



**UDHËRRËFYESI  
I STUDENTËVE**

# Vlerësimi

Kontrolli i dijeve realizohet nëpërmjet testimeve me shkrim dhe me gojë, detyrave të kursit, eseve, punëve në grup, projekteve, prezantimeve, praktikave dhe tezave të diplomës. Kontrolli i dijeve shërben për vlerësimin e progresit të studentit gjatë gjithë vitit akademik. Kriteri i vlerësimit përshkruan atë çfarë pritët të bëhet nga studenti dhe në çfarë niveli, me qëllim demonstrimin e arritjeve të objektivave formues dhe të kompetencave profesionale. Metodatat e vlerësimit janë strategjitë, teknikat, mjetet dhe instrumentet për grumbullimin e informacionit për të përcaktuar masën, në të cilën studenti demonstroi përvetësimin e objektivave formues të kompetencave profesionale të programit.

## Diplomimi dhe diploma

Në përfundim të kursit të plotë të studimeve, studenti ka të drejtë të diplomohet me mbrojtjen e një teze diplome, ose me provim formimi. Studentit i lejohej të mbrojë diplomën vetëm mbasi të ketë shlyer provimet e prapambetura. Diplomat që lëshohen në përfundim të programeve të studimit të ciklit të parë, të dytë, si dhe ato të ciklit të tretë, shoqërohen me suplementin e diplomës. Suplementi i diplomës hartohet në përputhje me kërkesat e Hapësirës Evropiane të Arsimit të Lartë dhe përshkruan natyrën, nivelin, përmbajtjen dhe rezultatet e studimeve që janë kryer nga mbajtësi i diplomës, si dhe fushën e punësimit.

Shpërndarja e diplomave bëhet gjatë një ceremonie të veçantë të quajtur "Dita Akadematike" e Universitetit të Korçës, e cila zhvillohet në përfundim të çdo viti akademik. Në këtë ditë studentët ekselentë vlerësohen me "Medalje të Artë". Studentët me mesatare mbi 9-të vlerësohen me certifikatën "Student i shkëlqyer" dhe të gjithë studentëve që kanë mesataren e përgjithshme mbi 8-të, u shënohet emri në Librin e Nderit të Universitetit.



## UDHËRRËFYESI I STUDENTËVE

# Regjistrimi

Kandidati që shpallet fitues për të studiuar në ciklin e parë, të dytë, ose të tretë "Master Ekzekutiv", ka të drejtë të ndjekë studimet në vitin e parë akademik në programin e studimit të kërkuar, nëse regjistrohet në sekretarinë mësimore të fakultetit dhe paguan tarifën e shkollimit sipas afateve të përcaktuara në udhëzimet përkatëse. Në rast të kundërt, ai humbet përfundimisht të drejtën e regjistrimit.

Në fillim të çdo viti akademik studenti është i detyruar të regjistrohet në sekretarinë mësimore të fakultetit për vitin në vazhdim brenda muajit tetor dhe të paguajë tarifën e detyrimeve për vitin akademik. Nëse nuk shlyen detyrimet deri në datën 31 janar të çdo viti akademik, studenti pengohet për të hyrë në provim. Në ato raste kur studenti ka provime para datës 31 janar duhet të paguajë tarifën e shkollimit një javë para datës së provimit, ndryshe nuk futet në provim. Kandidati fiton statusin e studentit, pasi ai është regjistruar në sekretarinë mësimore, ka plotësuar të gjitha detyrimet dhe zotëron vërtetimin e regjistrimit. Statusi i studentit përfundon me marrjen e diplomës, me përjashtimin ose largimin e tij nga Universiteti.

## Transferimet

UNIKO ofron mundësi për njohjen e krediteve dhe transferimin e studimeve, midis programeve të të njëjtit cikël studimi, brenda vetë Universitetit, apo universiteteve të tjera. Transferimet pranohen në fillim të çdo viti akademik, jo më vonë se fundi i javës së pestë të semestrit të parë.

Kuotat në dispozicion të transferimeve mund të shfrytëzohen edhe nga studentë, të cilët ndërpresin studimet në një program për t'u regjistruar në një program të të njëjtit cikël studimi, që i përket një fushe të ndryshme studimesh nga ajo e mëparshme, nëse numri i krediteve, që njihen është i mjaftueshëm për t'u regjistruar në vitin e dytë të studimeve.

**Për më shumë informacion, [klikoni këtu \(PDF\)](#)**



**UDHËRRËFYESI  
I STUDENTËVE**

# Biblioteka dhe databaza

**Biblioteka e UNIKO** përbëhet nga bibliotekat e katër fakulteteve, të cilat gjenden fizikisht në secilin prej tyre, si dhe biblioteka online U-Library. Çdo bibliotekë është në funksion të plotë të programeve të studimit që ofron secili department dhe përmbajnë botime dhe materiale për çdo program studimi. Në godinën e Rektoratit gjendet edhe “Biblioteka Shkencore” e cila përmban botime të përgjithshme për të gjitha fushat studimore të UNIKO dhe jo vetëm.

**U-Library** mund të aksesohet nga çdo student që ka një adresë email-i me të cilën është identifikuar në momentin e regjistrimit në UNIKO. Ky shërbim bibliotekar ofron akses në një numër të madh burimesh elektronike (mbi 170 mijë libra, 70 milion artikuj akademikë dhe gazetash të ndryshme), ku studentët mund të hyjnë paralelisht në platformë, që do të thotë se nuk ka një numër të kufizuar vendesh. Njëkohësisht U-Library ofron edhe shërbimin Rosseta-Stone për mësimin dhe përsosjen e përdorimit të gjuhëve të huaja nga studentët. Platforma Interaktive Rosseta-Stone e ofron këtë shërbim në 30 gjuhë të ndryshme.



## **Sekretaria online**

Të gjithë të dhënat e studentëve, që prej momentit të regjistrimit deri në përfundim të studimeve, ruhen në bazën e të dhënave të Universitetit. Në bazën e të dhënave shënohet e gjithë ecuria akademike e studentit. Sekretaria online, ku ruhen të gjithë të dhënat e studentit dhe ecuria akademike për gjithë kohën e studimeve, është ESSE3. ESSE3 është një platformë akademike ku secili student ka llogarinë personale.



**UDHËRRËFYESI  
I STUDENTËVE**

# **Sigurimi i cilësisë në UNIKO**

Senati i Universitetit me Vendimin nr. 33, datë 17.11.2009 vendosi ngritjen e Njesisë së Brendshme për Sigurimin e Cilësisë (NJSBC), si dhe përbërjen e saj.

Njësia e Brendshme për Sigurimin e Cilësisë zbaton mekanizma për sigurimin e cilësisë në mësimdhënie, vlerësimin dhe përfshirjen e studentëve në procesin e të nxënës. Këto njësi ngrihen në nivel fakulteti, ku njëri prej antarëve është i zgjedhur prej studentëve. NJSBC mbështet dhe ofron ekspertizë. Përfaqësuesit (anëtarët) e saj vizitojnë rregullisht çdo fakultet, çdo departament dhe ofrojnë ekspertizë në zhvillimin e proceseve përkatëse të sigurimit të cilësisë. NJSBC interpreton detyrimet kombëtare dhe evropiane të sigurimit të cilësisë, në mënyrë që t'i përshtatë ato në kontekstin institucional. NJSBC administron, organizon dhe përgatit vizita të vlerësimit të jashtëm ose fton ekspertë të jashtëm për të trajnuar stafin që merret me vlerësimin e brendshëm.





**UDHËRRËFYESI  
I STUDENTËVE**

## Zyra IT

Zyrat e IT janë të organizuara në fakultete, ndërsa zyra qendore është e vendosur në mjediset e Rektoratit. Zyrat e IT ofrojnë mbështetje teknike për problemet që mund të dalin si rezultat i përdorimit të platformës ESSE3 apo të çdo aspekti tjetër teknik të përfshirë në fushëveprimin e kësaj zyre. Zyrat e IT-së janë përgjegjëse për mirëmbajtjen e sistemit informativ të UNIKO. Në drejtim të ruajtjes dhe të fshehtësisë së të dhënave, zyrat e IT-janë përgjegjëse për marrjen e veprimeve të duhura me qëllim ofrimin e sigurisë për ruajtjen e çdo të dhëne bazuar në rregulloret e UNIKO.

## **IRO: Zyra e marrëdhënieve me jashtë dhe koordinatori ERASMUS+**

Zyra e marrëdhënieve me jashtë është e vendosur në mjediset e Rektoratit. Ajo ofron mbështetje për informacion rreth Universitetit, koordinon projekte të ndryshme, përmirëson kontaktet ndërmjet studentëve tanë dhe atyre të huaj, si dhe ofron mbështetje për çdo kërkesë të adresuar brenda funksionit të saj për studentët.

Kordinatori Erasmus + bën koordinimin e mobilitetit të studentëve në kuadër të programit Erasmus+, ofrimin e këshillave dhe udhëzimeve për studentët në lidhje me opsionet e mundshme për programe Erasmus +, siguron informacionin për studentët për mundësitë e vendosjes së mobilitetit në institucionet partnere të UNIKO.



**UDHËRRËFYESI  
I STUDENTËVE**

## **Këshilli studentor**

Këshillat e studentëve promovojnë dhe koordinojnë pjesëmarrjen e studentëve dhe përfaqësimin e tyre në organet drejtuese të Universitetit, si dhe në strukturat mësimore-kërkimore.

Këshilli i Përgjithshëm i Studentëve të Universitetit "Fan S. Noli" dhe Këshilli i Studentëve të çdo fakulteti zgjidhet me votim nga të gjithë studentët. Ai ka në përbërje të tij përfaqësues të studentëve nga të gjitha fakultetet. Këshilli Studentor shpreh mendime dhe propozime për të gjithaëproblemet me interes të përgjithshëm të universitetit, si: për planet dhe programet e studimeve, për rregulloret e veprimtarisë mësimore, cilësinë e

shërbimeve, zhvillimin e veprimtarive të ndryshme kulturore, artistike, sportive etj.

## **Qendra e Karrierës dhe ALUMNI**

Qendra e Karrierës dhe Alumni ofron shërbimin e mbështetjes për maturantët para dhe gjatë procesit të pranimit në UNIKO, si dhe ofron shërbimet më të mira për studentët e ardhshëm, studentët aktualë, të diplomuarit, stafin dhe grupet e tjera të interesit, në mënyrë që të përmirësohet cilësia e edukimit dhe t'i ndihmojë ata të zhvillojnë potencialin e plotë, për të patur një ndikim domethënës në tregun e punës dhe në shoqëri. Mjediset e Qendrës së Karrierës dhe Alumni janë të vendosura në godinën e Rektoratit.



**UDHËRRËFYESI  
I STUDENTËVE**

# Anekse

## **Rregullore e funksionimit dhe organizimit të Këshillit Studentor**

- [Kliko \(PDF\)](#)

## **Kodi i Etikës**

- [Kliko \(PDF\)](#)

## **Rregullorja e zhvillimit të provimeve**

- [Kliko \(PDF\)](#)